




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gjiçane  
Municipality of Gjiçane  
Gilan Belediyesi

Duke u bazuar në nenin 17 dhe 18 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, 01.Nr.016-126211 të datës 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet 01. 016-28448 të datës 22.03.2018, në zbatim të nenit 4 të Rregullores për Transparencë në Komuna, në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr 05/2013 për Transparencë në Komuna, njoftohen zyrtarët, qytetarët, shoqatat, grupet e interesit dhe bartësit e institucioneve të Komunës, anëtarët e Kuvendit të komunës, se me datë **13.03.2020 në ora 13:00** në sallën e Kuvendit të komunës së Gjiçanit, ish-ndërtesa e Gjykatës, do të mbahet:

## DËGJIM PUBLIK

Propozim:

RREGULLORJA KOMUNALE PËR KUTINË E ANKESAVE NË INSTITUCIONET  
E ARSIMIT PARAUNIVERSITARE

Qëllimi i diskutimit publik është krijimi i opinioneve pozitive për aktet në fjalë, të cilin pas zhvillimit të procedurave paraprake ligjore, duke përfshirë edhe dëgjimin publik me qytetarë, pjesëmarrës të tjerë, do të procedohet në Komitetin e Arsimit, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës për miratim.

Në dëgjim duhet të marrin pjesë, zyrtarë, mësimdhënës, nxënës, qytetarë, grupe të interesit (OJQ) për të shprehur mendimet e tyre në interes të përgjithshëm.

Projekt Rregullorja mund të merret në Zyrën Ligjore dhe do të jetë e publikuar edhe në web faqen e Komunës: [www.rks-gov.net/gjilan](http://www.rks-gov.net/gjilan)

Gjiçane, 26 shkurt 2020



Komuna e Gjiçanit